**LIGJ**
**Nr.7613, datë 18.9.1992**

**PËR MIRATIMIN ME NJË NDRYSHIM TË DEKRETIT NR.255, DATË 17.7.1992 "PËR DISA PLOTËSIME NË DEKRETIN NR.1874, DATË 7.6.1954 "MBI SHTETËSINË SHQIPTARE"**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 28 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Të miratohet dekreti nr.255, datë 17.7.1992 "Për disa pltoësime në dekretin nr.1874, datë 7.6.1954 "Mbi shtetësinë shqiptare", me këtë ndryshim:

Në nenin 1, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Personat që do të rezultojnë me më shumë se një shtetësi, si pasojë e zbatimit të këtij dekreti, do të gëzojnë të drejtat dhe do të përmbushin detyrat që parashikohen nga Kushtetuta dhe legjislacioni shqiptar në fuqi për çdo shtetas të Republikës së Shqipërisë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.319, datë 14.10.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.**